



safejournalists.net

# Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor

Narrative Report North Macedonia 2021

# PËRMBAJTJA

MJEDISI LIGJOR DHE ORGANIZATIV

9

PARANDALIMI

22

PROCES

32

SIGURIA FIZIKE

41

# Hyrja

Indeksi i sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor (Indeks) është një mjet i bazuar në hulumtim, i dizajnuar për të ndjekur ndryshimet në shoqërinë adekuate dhe rrethinën politike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo indirekt mbi sigurinë e gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë mediatik gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Indeksi mbështetet në të dhënat hulumtuese të mbledhura dhe të analizuar nga partnerët e platformës [SafeJournalists.net](https://www.safejournalists.net), duke u bazuar në një procedurë të rreptë hulumtuese. Të dhënat e mbledhura për dimensione të ndryshme të konceptit kompleks të "sigurisë së gazetarëve" janë kuantifikuar dhe mbledhur në një indikator të përbërë – Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve, në mënyrë që të maten ndryshimet në shtatë vende të Ballkanit Perëndimor që kanë ndodhur me kalimin e kohës. Në bazë të të dhënave të hulumtimit, nëntë anëtarë të Panelit Këshillues në secilin shtet<sup>1</sup> e kanë vlerësuar situatën dhe kanë dhënë nota për secilin nga 19 indikatorët në dimensionet si vijon:

- (1) **Mjedisi ligjor dhe organizativ** – ekzistenca dhe zbatimi i masave mbrojtëse ligjore, të rëndësishme për sigurinë e gazetarëve;
- (2) **Parandalimi** – ekzistenca dhe zbatimi i një sërë masash parandaluese që kanë efekte të drejtpërdrejta në mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve;
- (3) **Procesi** – sjellja e institucioneve shtetërore dhe funksionarëve publikë ndaj gazetarëve dhe efikasiteti i sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me hetimin e kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve;
- (4) **Siguria fizike** – incidente dhe raste të formave të ndryshme të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve dhe medieve.

Indeksi është përpiluar në bashkëpunim me hulumtuesit e Institutit RESIS<sup>2</sup> me seli në Shkup dhe partnerët e

<sup>1</sup> Panelin Këshillues në Maqedoninë e Veriut e përbëjnë: Adrian Kerimi, Darko Duridanski, Aleksandra Temenugova, Teofill Bllazhevski, Fatlume Dervishi, Sonja Kolevska Delevska, Vllado Apostollov, Almedina Ismaili dhe Llazar Sandev.

<sup>2</sup> Hulumtuesit e Institutit RESIS ([www.resis.mk](http://www.resis.mk)), Snezhana Trpevska, Igor Micevski dhe Ljubinka Popovska Tosheva e kanë zhvilluar kornizën konceptuale për Indeksën dhe modelin e vlerësimit të tij, peshimi dhe llogaritja.


platformës Safejournalists.net: Shoqatën e Pavarur të Gazetarëve në Serbi, Shoqatën e Gazetarëve nga Bosnja dhe Hercegovina, Sindikatën e Medieve nga Mali i Zi, Shoqatën e Gazetarëve të Kosovës, Shoqatën e Gazetarëve Kroat dhe një hulumtues të pavarur nga Shqipëria<sup>3</sup>. Prej këtu vijmë në konstatimin se Indeksi është rezultat i një mudi të përbashkët të Platformës Safejournalists.net dhe përfshin të gjithë çështjet specifike që partnerët lokal i kanë vërtetuar si relevante në kontekst të shteteve të tyre.

Viti i parë (pilot), për zhvillimin e kornizës konceptuale dhe metodologjisë së vlerësimit, grumbullimit dhe përlogaritjes së indeksit, ishte viti 2020. Ky raport ka të bëjë me gjendjen në Maqedoninë e Veriut gjatë vitit 2021 dhe i prezanton përmirësimet apo përkeqësimet e gjendjes për të gjithë katër dimensionet, duke marrë parasysh notën e vitit 2020 si një vit referues. Më shumë detaje lidhur me kornizën teorike dhe procedurën e zhvillimit dhe llogaritjes së Indeksit, si dhe të gjithë raportet për vendet e Ballkanit Perëndimor, mund ti gjeni në: (<https://safejournalists.net/safety-index/>).

---

3 Hulumtues i pavarur për platformën Safejournalists.net në Shqipëri është Blerjana Bino.

## INDEKSI I SIGURISË SË GAZETARËVE



	2020	2021		Ndryshimet e reja kryesore për secilin dimension
1. Mjedisi ligjor dhe organizativ	4.32	4.28	↓	Miratimi i paralajmëruar i ndryshimeve ligjore në aspekt të mbrojtjes më të madhe të gazetarëve dhe punonjësve mediatik, nuk ndodhi as në vitin 2021.
2. Parandalim	3.74	3.76	↑	Nuk janë vërejtur raste të mëdha të shkeljes së lirive dhe të drejtave mediatike. Është vendosur një praktikë e dënimit publik të sulmeve ndaj gazetarëve, por ekzistojnë raste kur politikanë dhe bartës të funksioneve publike ofendojnë dhe dërgojnë kërcënime në adresë të gazetarëve dhe medieve.
3. Proces	3.31	3.31		Nuk janë vërejtur ndryshime të dukshme, hetimet janë kryesisht të ngadalshme dhe jo efikase, ndërsa për sulme të caktuara madje fare nuk janë ngritur akuza.
4. Siguria fizike	4.13	4.17	↑	Numri i sulmeve fizike dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve është zvogëluar në krahasim me vitin e kaluar, por është shqetësuese që trend në rritje është kërcënimi online ndaj gazetarëve.
<b>Indeksi i sigurisë së gazetarëve</b>	<b>3.93</b>	<b>3.95</b>	<b>↑</b>	

## — REZYME

### I. MJEDISI LIGJOR DHE ORGANIZATIV

- Gazetarët nuk e vlerësojnë Ligjin për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje si kufizues, dhe numri i lëndëve kundër gazetarëve është zvogëluar shumë. Gjykatat nuk kanë konstatuar fajësi të ndonjë gazetari në asnjë prej procedurave gjyqësore për ofendim dhe shpifje dhe nuk kanë marrë vendime për kompensim të dëmit nga imazhi i dëmtuar,
- Në vitin 2021, nuk ka pasur ndryshime në aspekt të garancive ligjore për mbrojtje të burimeve të gazetarëve dhe zbatimin e tyre në praktikë. Ligjet mundësojnë një mbrojtje të mirë të burimeve të gazetarëve. Gazetarët ndjehen të lirë që të kontaktojnë me burimet e informacionit. Megjithatë është ende i vogël numri i informatorëve që denoncojnë raste të korrupsionit deri tek institucionet kompetente apo tek gazetarët

që do të thotë se ende ekziston atmosfera e frikës tek burimet, gjë që nuk është e volitshme për gazetarinë,

- Në vitin 2021, shteti ende nuk ka ndërmarrë aktivitete për vendosjen e mbrojtjes ligjore nga të ashtuquajturat padi strategjike të pabaza për pengimin e pjesëmarrjes publike (SLAPP), edhe pse është regjistruar praktika e shfrytëzimit të këtyre padive në disa raste, gjë që tregon qartë tentativën e disa personave të fuqishëm që të bëjnë presion ndaj gazetarëve; është vërejtur edhe një rast i kërcënimit të sigurisë së ekipit të gazetarëve gjatë raportimit nga protestat,
- Në vitin 2021 nuk kishte ndryshime sa i përket lirisë së gazetarëve që ta ushtrojnë profesionin e tyre dhe të bashkohen në shoqata profesionale. Profesionin e gazetarit nuk është pre e licencimit, edhe pse në Ligjin për Medie ekziston një definicion i rreptë i termit gazetar. Ekzistojnë disa shoqata profesionale, por presion është vërejtur të ketë në aspekt të lirisë së organizimit sindikalist. Pronarët apo menaxherët e medieve private i pengojnë (edhe pse në mënyrë subtile) gazetarët që të anëtarësohen në sindikatën e gazetarëve dhe të themelojnë organizim sindikalist brenda medieve,
- Gjendja me të drejtat e punëtorëve dhe statusin e punës së gazetarëve në vitin 2021 nuk ka ndryshuar. Të ardhurat e ulëta dhe mosrespektimi i të drejtave nga marrëdhënia e punës janë problemet kryesore me të cilat ballafaqohen gazetarët në mediet private. Në servis publik, gjendja është pak më e mirë. Gazetarët frikësohen që të iniciojnë procedura gjyqësore për mobing apo për mosrespektimin e të drejtave të punëtorit apo të themelojnë organizata sindikaliste brenda medieve ku punojnë. Redaksitë që ofrojnë ndihmë falas juridike për gazetarët që ballafaqohen me padi për ofendim, shpifje apo ngjashëm janë të rralla.

## II. PARANDALIM

- Gjatë vitit 2021, nuk kishte ndryshim sa i përket gjendjes lidhur me zbatimin e masave të shpejta dhe efektive për mbrojtjen e gazetarëve në raste të kërcënimeve apo sulmeve. Mekanizmi për denoncimin e sulmeve nga ana e gazetarëve në MPB, respektivisht linja telefonike për ndihmë të shpejtë dhe efikase të gazetarëve në rast të sulmeve, nuk funksionoi as në vitin 2021. Pas heqjes së linjës, vazhdoi mundësia për denoncim, por kësaj radhe nëpërmjet një formulari online në ueb faqen e LSGPM - <https://ssnm.org.mk/prijavi>. Gazetarët që ishin pre e sulmeve nuk kishin ku të drejtohen për ndihmë direkte apo mbështetje nga institucionet, përveç në Sektorin për Kriminalitet Kompjuterik dhe Forenzikë Digjitale në kuadër të MPB-së apo në SHGM. Prej pesë sulmeve ndaj gazetarëve, vetëm një ishte proceduar.

- Në vitin 2021, nuk kishte ndryshime sa i përket disponueshmërisë së masave të veçanta për mbrojtje fizike të gazetarëve. Në rregullativën ligjore ekzistojnë dispozita të përgjithshme sipas të cilave gazetarët do të mund të kërkojnë mbrojtje në rast të ndonjë kërcënimi më serioz ndaj jetës nga person i njohur, por nuk është shumë e qartë se sa kjo procedurë është e zbatueshme në aspekt praktik. Ekziston procedurë në Ligjin për Procedurë Penale, por procedura për vlerësimin e rrezikut nuk është definuar në mënyrë të qartë.
- Në vitin 2021, nuk kishte ndryshim të gjendjes lidhur me qasjen e gazetarëve në ndihmë juridike apo masa të reja për mbështetje në raste të kërcënimeve të bazuara në gjini, sulmeve apo diskriminimit të bazuar në gjini. Ende nuk ishte zbatuar mekanizmi për ndihmë juridike falas për cilëndo viktimë të sulmeve apo dhunës së bazuar në gjini, përfshirë këtu edhe gazetaret. Të gjithë sulmet, gazetaret i denoncojnë në MPB. Në adresë të SHGM-së në vitin 2021 janë paraqitur tre sulme, por praktika dëshmon se numri real i sulmeve është shumë më i madh. Gazetarët shumë rrallë i denoncojnë rastet e diskriminimit të bazuar në gjini tek institucionet kompetente.
- Gjendja në vitin 2021 nuk është ndryshuar në krahasim me vitin paraprak. Është vendosur praktikë e dënimit publik të sulmeve ndaj gazetarëve. Bartësit e funksioneve publike kryesisht përmbahen nga sulmet verbale ndaj gazetarëve, me përjashtim të rasteve individuale kur politikanët apo bartësit e funksioneve publike kanë sulmuar verbalisht gazetarët. SHGM në vitin 2021 ka vërejtur dy raste të tilla.
- Vlerësimi i përgjithshëm është se policia gjatë vitit 2021 ka treguar një sjellje korrekte ndaj gazetarëve dhe medieve në situata të ndryshme. Merret parasysh që gjatë trajnimeve të policëve të përfshihen tema që lidhen me të drejtat e njeriut, ndërsa në ligjet dhe kodekset sipas të cilëve punon policia, janë vendosur standardet ndërkombëtare. Bashkëpunimi i rregullt mes SHGM-së dhe MPB-së ka vazhduar edhe në vitin 2021.

### III. PROCES

- Bashkëpunimi mes institucioneve kompetente edhe në vitin 2021 nuk ishte përmirësuar dhe nuk rezultoi me efikasitet të mjaftueshëm për zbulimin e autorëve të sulmeve. Prokurorët publik janë tejet pasiv në aspekt të nisjes së proceseve. Institucionet kompetente nuk kanë reparte të veçanta e as persona të caktuar për të udhëhequr me hetimet për sulmet ndaj gazetarëve. Nuk janë miratuar as udhëzime të veçanta që do të ndihmojnë për zhvillimin më efikas të hetimeve.
- Edhe pse mosndëshkimi është ende problem i madh, është arritur një avancim i vogël në vitin 2021 për shkak

të sanksionimit të shpejtë dhe efikas të një kërcënimi serioz ndaj gazetarët, që ishte lëshuar online. Por ende mbetet problemi i hetimeve të ngadalshme dhe joefikase, ndërsa për raste të caktuara të sulmeve ndaj gazetarëve, madje fare nuk janë ngritur as hetime. Megjithatë, është fakt pozitiv që institucionet kompetente janë të hapura për bashkëpunim me SHGM-në dhe nëpërmjet konsultimeve të përbashkëta dëshmojnë gatishmërinë për të punuar në përmirësimin e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

- Gjatë vitit 2021 ka një përmirësim të konsiderueshëm në aspekt të mbrojtjes së gazetarëve nga sulmet online, pasi që institucionet kompetente kanë reaguar shpejtë dhe në mënyrë efikase për gjetjen dhe sanksionimin e autorit të një kërcënimi serioz online ndaj të gjithë gazetarëve, që e kishte shkruar në faqen e Fejsbuk-ut të SHGM-së. Megjithatë, SHGM ende nuk ka marrë asnjë informacion se si ka vepruar prokuroria me rastet e tjera të sulmeve online ndaj gazetarëve që kanë ndodhur gjatë vitit 2021.
- Gjendja sa i përket transparencës së procedurave gjyqësore në të cilat palët janë gazetarët, nuk është përmirësuar. Gjykatat Themelore Penale dhe Themelore Civile nuk ofrojnë detaje lidhur me procedurat gjyqësore për sulmet ndaj gazetarëve që kanë ndodhur gjatë viteve të fundit. Gjykatat nuk kanë praktikë të informimit të opinionit për procedurat gjyqësore kundër gazetarëve apo për rastet kur gazetarët janë palë e dëmtuar si cak i sulmeve. Përpos kësaj, sistemi i automatizuar informatik për menaxhim me rastet (AKMIS) nuk jep mundësi për kërkim preciz të proceseve të kaluara apo vijuese në të cilat palë janë gazetarët, dhe kështu opinioni ka qasje të vështirësuar deri tek këto informacione.
- Gjendja lidhur me mbajtjen e bazave precize të të dhënave nuk është ndryshuar në krahasim me vitin e kaluar. Gjykatat dhe institucionet kompetente edhe përkaj të iniciativave të SHGM-së, ende nuk kanë vendosur sisteme kualitative statistikore, në bazë të të cilave mund të dorëzohen të dhëna të sakta për të gjitha procedurat gjyqësore në të cilat palë janë gazetarët apo mediet. Bazat e të dhënave të gjykatave nuk lejojnë kërkim të të dhënave sipas kriterëve të ndryshme.

#### **IV. SIGURIA FIZIKE**


- Në vitin 2021 kishte një përmirësim të vogël në kontekst të llojit të tillë të sulmeve (kërcënime jo fizike dhe ngacmim) ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në shtet, për dallim prej vitit 2020 kur SHGM kishte regjistruar shtatë raste. Janë regjistruar një numër i vogël i sulmeve që nuk kanë të bëjnë me kërcënimin e sigurisë fizike të gazetarëve. Megjithatë, shqetësuese është që në mesin e autorëve janë edhe zyrtarë policor dhe përfaqësues të partive politike.



- Në vitin 2021 është regjistruar vetëm një kërcënim ndaj sigurisë fizike dhe jetës së gazetarëve, që është një përmirësim në krahasim me vitin 2020 kur SHGM ka regjistruar tre raste. MPB ka dorëzuar njoftim deri tek SHGM-ja se është ngritur kallëzim penal kundër A.E. (36) nga fshati Tearcë i Tetovës për shkak të dyshimeve për kryerjen e veprës penale “kërcënim të sigurisë” ndaj gazetarëve. Përgjigja e MPB-së ndaj këtij rasti është për tu përshëndetur ndërsa hapi i ardhshëm do të jetë veprimi urgjent i prokurorisë, ndërsa pastaj i gjykatës me qëllim që ata që i cenojnë dhe të drejtat e gazetarëve të ballafaqohen me drejtësinë. Për këtë rast MPB ka nisur procedurë ndaj kërcënuesit, por ende nuk ka informacion për vijimin e procedurës lidhur me këtë rast. Është shqetësues fakti se ky lloj i kërcënimeve drejtohen kryesisht online dhe ndaj gazetarëve.
- Në vitin 2021 është regjistruar një sulm fizik ndaj gazetarëve, për dallim prej vitit 2020 kur kishte dy raste të tilla. Më konkretisht gjatë kohës së protestave të qytetarëve të pakënaqur dhe familjarëve të të akuzuarve në rastin “Monstra”, në adresë të SHGM-së erdhi denoncim nga kolegë të Agjencisë Mediatike Informative (MIA) se ka patur tentim për tua marrë pajisjet anëtarëve të ekipit të tyre, pas çka kameramani është shtyrë ndërsa pajisjet janë dëmtuar. SHGM nëpërmjet një njoftimi me shkrim i dënoi në mënyrë publike sulmuesit.
- SHGM në vitin 2021 nuk ka regjistruar sulme apo kërcënime ndaj medieve ose shoqatave të gazetarëve.

# Mjedisi ligjor dhe organizativ

4,28



# Dispozitat ligjore që lidhen me shpifjen dhe zbatimi i tyre nuk krijojnë efekte të frikës ndaj gazetarëve dhe medieve

**Rezultati për vitin 2020: 4.58 /  
Rezultati për vitin 2021: 4.58**

**Vlerësimi i përgjithshëm nga raporti i mëparshëm vlen ende edhe për këtë vit: Gazetarët nuk e vlerësojnë Ligjin për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje (LPCOSH) si kufizues dhe numri i lëndëve kundër gazetarëve është zvogëluar shumë. Gjykatat nuk kanë konstatuar përgjegjësi për ndonjë gazetar në asnjë prej proceseve gjyqësore për shpifje apo ofendim dhe nuk kanë dhënë verdikt për kompensim të dëmit për cenim të imazhit dhe nderit.**

Që prej vitit 2012, me sjelljen e Ligjit për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje (LPCOSH), veprat e ofendimit dhe shpifjet ishin de-kriminalizuar. Në Kodin Penal ekzistojnë dispozita për cenim të nderit të shtetit, të ndonjë shteti të huaj apo përfaqësuesi diplomatik, pastaj popullit maqedonas apo bashkësive. Megjithatë, ekziston dispozitë me të cilën gazetari përjashtohet nga përgjegjësia kur mendimi është dhënë "gjatë ushtrimit të profesionit të gazetarit, në mbrojtje të lirisë së shprehjes publike të mendimit apo të të drejtave të tjera, apo gjatë mbrojtjes së interesit publik apo interesave të tjera të arsyetuara, apo me qëllim të sigurtë apo bindje në qëllimin e mirë të mendimit të tij". Vlerësimi i Shoqatës së Gazetarëve dhe ekspertëve juridik është se Ligji për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje (LPCOSH) përmban disa dispozita të paqarta, si dhe fakti se kompensimet për dëm jo-material janë tejet të larta dhe mund të kenë ndikim negativ tek gazetarët. Prandaj, në propozim ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit të përpiluara në vitin 2020, ishin paraparë tre çështje kryesore : ndryshimi i parë ka të bëjë me definimin e ofendimit dhe shpifjes si vepra që janë nxjerrë para personit të tretë, respektivisht në publik, sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndryshimi i dytë ka të bëjë me zvogëlimin e shumës për kompensim të dëmit, ndërsa i treti për plotësim të dispozitave për përgjegjësi për shpifje, në kuptim të asaj se përveç gazetarit, për shpifjen ose ofendimin do të përgjigjet edhe autori i deklaratës, redaktori apo personi që e zëvendëson në mjetin e informimit publik dhe personi juridik "(neni. 8). Me ndryshimet,

— INDIKATORI 1.1

përgjegjësi mund të bartë edhe personi fizik i cili është pronar i mjetit për informim publik. Lidhur me kompensimin për dëm jo-material, parashikohet zvogëlim i dhjetëfishit të shumave. Sipas dispozitave të tanishme, për dëm të shkaktuar me ofendim dhe shpifje nga ana e gazetarit është parashikuar kufizimi i kompensimit të dëmit deri në 2 mijë euro, për redaktor apo person që e zëvendëson atë kompensim maksimal deri në 10 mijë euro, ndërsa për personin juridik deri në 15 mijë euro. (neni 18 nga LPCOSH). Me ndryshimet e Ligjit, këto shuma në të ardhmen do të ishin nga 200, 1000 dhe 1500 euro. Miratimi i paralajmëruar i këtyre ndryshimeve nuk ndodhi deri në fund të vitit 2021. Sipas të dhënave të marra nga Gjykata Themelore Penale në Shkup, numri total i lëndëve aktive për ofendim dhe shpifje ndaj gazetarëve apo medieve në vitin 2021 ka qenë 20. Gjatë vitit 2021, SHGM nuk ka regjistruar ndonjë procedurë të përfunduar gjyqësore në të cilën ndonjë gazetar është dënuar dhe është detyruar që të paguajë dëm jo-material për shkak të cenimit të imazhit. Vetë gazetarët nuk vlerësojnë se Ligji për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje (LPCOSH) është restriktiv, numri i lëndëve kundër gazetarëve dhe medieve është zvogëluar shumë. Gjatë viteve të fundit në shtet, ofendimi dhe shpifja gjithnjë e më pak përdoren si instrument për presion ndaj gazetarëve dhe medieve. Gjatë viteve të fundit nuk janë vërejtur vendime gjyqësore me të cilat gazetarët do të përgjigjeshin për shpifje e që do kishte shkaktuar efekt negativ ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në ditët e sotme.

# Besueshmëria e burimeve të gazetarëve është e garantuar në legjislativ ndërsa respektohet edhe nga autoritetet

**Rezultati për vitin 2020: 4.80 /  
Rezultati për vitin 2021: 4.80**

**Në vitin 2021 nuk kishte ndryshime lidhur me garancitë ligjore për mbrojtje të burimeve të gazetarëve dhe zbatimin e tyre në praktikë. Ligjet ofrojnë mbrojtje të mirë të burimeve të gazetarëve. Gazetarët ndjehen të lirë për të kontaktuar burimet e informacionit. Megjithatë, numri i informatorëve që denoncojnë raste të korrupsionit tek institucionet apo mediet është ende i ulët, gjë që dëshmon faktin se ende mbizotëron atmosfera e frikës tek burimet, që fundi fundit nuk është në favor për vetë gazetarinë.**

E drejta për mbrojtje të burimit të gazetarit në RMV është një kategori kushtetuese, dhe kjo garantohet me Kodin Penal, Ligjin për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje, Ligjin për Medie dhe Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audio-vizuele. Më tej, me Ligjin për Mbrojtje të Informatorëve janë rregulluar çështjet e denoncimit të mbrojtur, të drejtat e informatorëve si dhe veprimin dhe obligimet e institucioneve lidhur me denoncimin e mbrojtur dhe ofrimin e sigurisë për informatorët. Me ndryshimet e këtij ligji në vitin 2018, u bë harmonizimi me standardet ndërkombëtare të parapara në këtë fushë dhe me të sigurohet më shumë mbrojtje e informatorëve. Në vitin 2021 nuk është regjistruar asnjë rast kur zyrtarët kanë kërkuar prej gazetarëve që ta tregojnë burimin, apo rast kur ndonjë gazetar është sanksionuar për shkak se nuk ka dashur ta tregojë identitetin e burimit të informacionit. Në mënyrë shtesë, deri tek SHGM nuk ka pasur raste të denoncuar për tentativa që ti merret telefoni apo kompjuteri ndonjë gazetari që të zbulohet burimi i informacionit. Vlerësimi i përgjithshëm është se gjatë përpunimit të teksteve hulumtuese, gazetarët ndjehen të lirë për të kontraktuar me burimet e informacioneve. Megjithatë, edhe pse burimet e gazetarëve janë të inkurajuar dhe të mbrojtur institucionalisht, një numër shumë i vogël i

— INDIKATORI 1.2

informatoreve denoncojne raste tek institucionet kompetente apo tek gazetarët, që do të thotë se ende mbizotëron atmosfera e frikës tek burimet e gazetarëve gjë që fundja nuk është e favorshme për gazetarinë në përgjithësi.

# Ligjet e tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe ju mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatik që të punojnë në mënyrë të lirë dhe të sigurt

**Rezultati për vitin 2020: 4.57 / Rezultati për vitin 2021: 4.37**

**Në vitin 2021, shteti ende nuk kishte ndërmarrë aktivitete për vendosjen e mbrojtjes ligjore nga të ashtuquajturat padi strategjike kundër pjesëmarrjes publike (padi SLAPP) edhe pse praktika e tillë është regjistruar në disa raste të cilat dëshmojnë në mënyrë të qartë se bëhet fjalë për një tentim të personave me pushtet dhe fuqi që të bëjnë presion ndaj gazetarëve; është vërejtur edhe një rast i kërcënimit të sigurisë së ekipit të gazetarëve gjatë raportimit nga protesta.**

Në vitin 2021, nuk janë vërejtur shembuj të zbatimit arbitrar apo diskriminues të ligjeve të tjera me qëllim që të kufizohet liria e punës së gazetarëve. Ajo që shqetëson është trendi në rritje i padive SLAPP që ngrihen kundër gazetarëve në shtetin tonë. Ky lloj i padive ka për qëllim që të shkaktojë frikësim dhe harxhime juridike apo thjeshtë lodhjen e personave të paditur, në këtë rast, gazetarëve, me qëllim që ata të de-motivohen dhe të heqin dorë nga kritika publike. Paditë e tilla në kontekst të Këshillit të Evropës janë të njohura si padi strategjike për pengimin e pjesëmarrjes publike (SLAPP). Këto padi, sidomos kur inicohen nga politikanë dhe bartës të funksioneve publike, mund të shkaktojnë vetë-censurë tek gazetarët dhe me këtë të cenohet e drejta e qytetarëve për tu informuar.

Nuk janë regjistruar as tentativa për heshtje të gazetarëve bazuar në zbatimin arbitrar të dispozitave ligjore që lidhen me shpërndarjen e dezinformatave, frikën apo panikun, edhe pse gjatë pandemisë kishte shembuj për shpërndarjen e dezinformatave.

Në shtetin tonë nuk ekzistojnë mekanizma mbrojtëse ligjore që do ti mbronin gazetarët nga të paditë e ashtuquajtura

SLAPP. Ky lloj i padive strategjike ka për qëllim që të shkaktojë frikësim dhe harxhime juridike apo thjeshtë lodhjen e personave të paditur, në këtë rast, gazetarëve, me qëllim që ata të demotivohen dhe të heqin dorë nga kritika publike. Këto padi, sidomos kur iniciohen nga politikanë dhe bartës të funksioneve publike, mund të shkaktojnë vetë-censurë tek gazetarët dhe me këtë të cenohet e drejta e qytetarëve për tu informuar.

Gjatë vitit 2021, SHGM ka regjistruar katër raste të tilla : në rastin e parë gazetari që ishte paditur ishte Aleksandar Damovski nga Mkd.mk, ndërsa paditësi ishte ish funksionari qeveritar Gorjan Tozija. Rasti i dytë ishte kur gazetarja e IRL-së Sashka Cvetkovska ishte paditur nga një ish funksionar qeveritar, respektivisht nga zëvendës kryeministri i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut Koço Angjushev. Një shembull tipik për padi të llojit SLAPP ishte padia nga ish kryetari i komunës Aleksandar Naumovski, ndaj gazetarit Srgjan Stojančov për të cilin gjykata në Shkup solli vendim në favor të gazetarit. Poashtu, janë vërejtur edhe padi ndaj gazetarëve Meri Jordanovska dhe Predrag Petroviq të cilët ishin paditur nga një deputet aktual në Parlament dhe kryetar i partisë politike, Dimitar Apasiev. Në fazën e parë të gjykimit, gjykata solli vendim në favor të gazetarëve, pra hodhi poshtë paditë ndaj gazetarëve, por për momentin procesi është në fazën e ankimimit. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë ofron ndihmë juridike falas dhe mbulon harxhimet për avokat për gazetarët dhe mediet që janë pre e padive. Në vitin 2021 është regjistruar vetëm një rast i kërcënimit të sigurisë së gazetarëve gjatë raportimit nga protestat. Në shkurt të vitit 2021, ekipi i Agjencisë Mediatike Informativ (MIA) që po raportonte nga protestat lidhur me rastin "Monstra", ishte sulmuar, ndërsa pajisjet për filmim ishin dëmtuar. Raste të tjera të zbatimit arbitrar apo diskriminues të ligjeve të tjera, me qëllim që të kufizohet liria e punës së gazetarëve, gjatë vitit 2021 nuk janë vërejtur.



# Gazetarët janë të lirë që të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të themelojnë, të bashkohen apo të marrin pjesë në shoqatat e tyre

**Rezultati për vitin 2020: 4.32 / Rezultati për vitin 2021: 4.32**

**Në vitin 2021 nuk kishte ndryshime sa i përket lirisë së gazetarëve që të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të anëtarësohen në shoqata profesionale. Profesionin e gazetarit nuk është pre e licencimit, edhe pse Ligji për Medie përmban definicion restriktiv për termin gazetar. Ekzistojnë disa shoqata profesionale por presionet ndaj gazetarëve që janë vërejtur janë kryesisht në aspekt të organizimit sindikal. Pronarët apo menaxherët e medieve private i pengojnë (edhe pse në mënyrë subtile) gazetarët që të anëtarësohen në ndonjë sindikatë të gazetarëve dhe të themelojnë degë të sindikatës brenda medieve.**

Profesionin e gazetarit nuk është pre e licencimit dhe gjatë vitit 2021 nuk ka pasur tentativa apo iniciativa që të vendoset çfarëdo lloji i licencimit të gazetarëve. Siç është theksuar edhe në raportin e kaluar të vitit 2020, Ligji për Medie përmban definicion për termin gazetar që është kufizues për lirinë e punës së gazetarit, pasi që me ligj caktohet se "kush mundet" ta ushtrojë këtë profesion. Megjithatë, në praktikë nuk janë vërejtur raste të kufizimit të individëve për të punuar si gazetarë. Në vitin 2021, SHGM nuk ka vërejtur raste në të cilat gazetarëve apo punonjësve mediatik nuk ju është mundësuar që të raportojnë prej ngjarjeve për shkak të mungesës së akreditimeve. Megjithatë, gjatë promovimit të iniciativës "Open Balkan" në kuadër të Forumit Ekonomik për bashkëpunim rajonal të organizuar nga qeveritë e Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Shqipërisë në korrik të vitit 2021, disa gazetarë janë pamundësuar që të raportojnë nga ngjarja në mënyrë profesionale për shkak të arsyeve teknike, organizative dhe mungesës së hapësirës. Fakti që disa gazetarë janë pamundësuar që të raportojnë i ka vendosur në pozitë jo të barabartë dhe diskriminuese në krahasim me kolegët e tjerë

që nuk janë ballafaquar me këtë gjë. Lidhur me këtë rast, SHGM ka reaguar në mënyrë publike deri tek organizatori i ngjarjes. Një rast i tillë është vërejtur nga gjykata e vendit në vitin 2021. Më konkretisht, Gjykata Themelore Civile në Shkup në muajin prill të vitit 2021, e ka refuzuar padinë për pengimin e të drejtës së informimit të qytetarëve si dhe për kompensim të dëmit jomaterial për shkak të frikës së përjetuar dhe dhimbjes shpirtërore të Goran Trpenovskit i cili gjatë incidenteve në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut më 27 prill të vitit 2017, si gazetar ka raportuar për mediumin online САКАМДАКАЖАМ.МК (sdk.mk). Në verdikt gjykata është arsyetuar se në atë kohë, Trpenovski nuk ka qenë gazetar pasi që ka punuar në medien online САКАМДАКАЖАМ.МК, i cili sipas gjykatësit, duke u thirrur në Ligjin për Medie, nuk llogaritet si medie. Në mënyrë shtesë, gjykata në këtë verdikt nuk e pranon të drejtën e informimit si kategori kushtetuese, duke vlerësuar se gjatë asaj kohe gazetari Trpenovski është penguar që ta informojnë opinionin maqedonas për ngjarjet në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut, dhe si pasojë, nuk ka të drejtë për kompensim të dëmit. Ky vendim gjyqësor është problematik nga disa aspekte. Së pari, ky vendim nuk është në pajtueshmëri me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të cilën është e padyshimtë se mediet online janë medie, ndërsa gazetarët që punojnë në këto medie janë bartës të këtij profesioni me çka gjykatat në shtet e kanë për obligim që ta ndjekin praktikën GJEDNJ. Gjykata me këtë verdikt nuk e respekton konkluzën e katër gjykatave të apelit në Maqedoninë e Veriut sipas të cilave, mediet online të cilat si palë paraqiten para gjykatave civile të shkallës së parë, gjatë procedurave për ofendim dhe shpifje duhet të kenë trajtimin e njëjtë sikurse mediet tradicionale prej muajit maj të vitit 2019. Kjo konkluzë e katër gjykatave të apelit duhet të jetë një leksion që edhe në procedurat e tera në të cilat gazetarët e medieve online kërkojnë drejtësi para gjykatave, nuk guxojnë të refuzohen me arsyetimin se nuk janë bartës të këtij profesioni.

Verdiktet e tilla gjyqësore e kërcënojnë lirinë e shprehjes dhe e diskreditojnë profesionin e gazetarit, si dhe rolin e medieve në një shoqëri demokratike. Shumica e gazetarëve janë të organizuar në shoqata profesionale. Shoqata më e vjetër dhe më e madhe është Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), e themeluar në vitin 1946, anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (FNG) dhe Federatës Evropiane të Gazetarëve (FEG). Ekziston edhe Këshilli i Etikës në Medie si një trup vetërregullues në të cilin janë të anëtarësuar në mënyrë vullnetare një numër i madh i medieve radiodifuzive, medieve të shkruara dhe medieve online. Lidhur me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, gazetarët dhe punonjësit mediatik janë organizuar në kuadër të Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik – SPGPM që është e pavarur dhe nuk është pjesë e asnjë organizate sindikale në nivel kombëtar.

Ekziston edhe një sindikatë e veçantë e radiodifuzerit publik, që nuk është pjesë e SPGPM-së. Sipas përfaqësuesve të SPGPM-së, pronarët dhe menaxherët e më shumë

— INDIKATORI 1.4

firmave private ( sidomos disa prej televizioneve në nivel shtetëror) në forma subtile pengojnë gazetarët që të kyçen në sindikatën e gazetarëve apo që të themelojnë organizata sindikaliste në kuadër të medieve të tyre. Në të kaluarën ka pasur tentim për formimin e organizatave paralele dhe shoqatave që kanë qenë nën ndikim politik, por që nuk kanë gëzuar besueshmëri dhe njohje nga ana e këtij sektori.

# Pozita e gazetarëve në vendin e punës është stabile dhe e mbrojtur

**Rezultati për vitin 2020: 3.34 /  
Rezultati për vitin 2021: 3.34**

**Gjendja me të drejtat e punëtorit dhe statusin e punës së gazetarëve nuk është ndryshuar gjatë vitit 2021. Të ardhurat e ulëta dhe mosrespektimit i të drejtave nga marrëdhënia e punës, janë ndër problemet kryesore me të cilat ballafaqohen gazetarët në mediet private. Në servis publik radiodifuziv, gjendja është pak më e mirë. Gazetarët frikësohen që të ngrënë procedura gjyqësore për mobing apo për mosrespektim të të drejtave të punëtorit dhe të formojnë organizata sindikaliste në medie. Rrallë herë ka redaksi të cilat ofrojnë ndihmë falas juridike për gazetarët në rast të padive për ofendim, shpifje e të tjerë.**

Edhe në vitin 2021 si në vitet paraprake, nuk mund të gjenden të dhëna precize për atë se sa gazetarë kanë nënshkruar marrëveshje për punë. Një vlerësim i përgjithshëm është se shumë gazetarë të medieve private kanë kryesisht marrëveshje të nënshkruara me afat të caktuar kohor, apo janë të angazhuar me honorarë. Vazhdon trendi i punës jashtë orarit të gazetarëve që punojnë në medie private ndërsa nuk paguhen, punojnë pa kompensime edhe gjatë festave dhe fundjavave.

Reforma në servis publik ishte një prej çështjeve kryesore në kuadër të kërkesës së sektorit civil për reforma gjithëpërfshirëse në sferën e medieve në shtet. Kjo kërkesë para së gjithash lidhej me rritjen e buxhetit për këtë medium, si dhe nevojën për të siguruar pavarësi më të madhe të servisit publik, duke filluar nga zgjedhja e anëtarëve të rinj të Këshillit Programor të Radio-televizionit të Maqedonisë së Veriut (RTVM). Financimi i RTVM-së ishte ndryshuar në mënyrë themelore në vitin 2018 kur taksa radiodifuzive (pagesë publik) u shndërrua në përqindje fikse nga Buxheti i RMV-së me qëllim që të sigurohet financim afatgjatë dhe stabil të servisit. Edhe përkundër kësaj, RTVM ende ballafaqohet me probleme financiare për shkak të borxheve nga vitet e kaluara, dhe për shkak të faktit që Qeveria nuk i ka paguar të gjitha paratë me rregull, sipas dinamikës së paraparë. Sipas vlerësimeve të

SHGM-së, RTVM në vitin 2021 ka marrë të ardhurat më të ulëta nga tre vitet e fundit. Nga ana tjetër, obligimet programore të RTVM-së madje janë shtuar me hapjen e kanalit 24 orësh në gjuhën shqipe dhe serviset e saj tematike (kanalet për fëmijë dhe për sport). Një kategori e rrezikuar e gazetarëve janë poashtu korrespondentët e RTMV-së të cilat janë në numër më të vogël dhe kanë kryesisht kontrata për angazhim të përkohshëm që mund të anulohen shumë lehtë. Në nëntor të vitit 2019, ishte publikuar një konkurs për angazhim me honorar të dhjetë korrespondentëve gjë që është një avancim për RTVM-në, edhe pse SHGM angazhohet për një model tjetër me të cilin do të zgjidhej kjo çështje e kësaj kategorie të gazetarëve në mënyrë të përhershme. Të ardhurat e ulëta dhe mosrespektimi i të drejtave nga marrëdhënia e punës, janë ndër problemet kryesore me të cilat ballafaqohet sektori i gazetarisë. Sipas të dhënave të Sindikatës së Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGPM), shumica e gazetarëve dhe punonjësve mediatik marrin paga nga 15 000 deri më 20 000 denarë. Gjatë pandemisë në të vitin 2020, më shumë medie private i kanë ulur pagat e gazetarëve dhe punonjësve mediatik, ndërsa niveli i tillë i pagave ka vazhduar edhe në vitin 2021. Një numër i madh i gazetarëve ankohen ende se nuk iu paguhen kontributet pensionale dhe shëndetësore. Në servisin publik të gjithë të punësuarve, që në tetor të vitit 2019 u janë rritur pagat në mënyrë lineare për 3500 denarë neto për person, ndërsa poashtu ishte nënshkruar një marrëveshje kolektive me të cilën garantohet pagesa e regresit për pushim vjetor. Kështu në një masë të konsiderueshme është përmirësuar standardi i gazetarëve dhe personelit teknik në RTVM, mirëpo ende ekziston perceptimi se pagat e gazetarëve, sidomos të atyre që janë fillestare, janë më të ulëta se sa të atyre që punojnë me honorarë në televizionet kombëtare private.

Megjithatë, për dallim prej disa prej medieve private, rregullshmëria e pagesave të pagave të të punësuarve në RTVM asnjëherë nuk ka qenë problematike, është problematike as siguria e vendit të tyre të punës që është e garantuar me marrëveshjet e nënshkruara.

Vlerësimi i përgjithshëm është se pozita e gazetarëve në redaksi nuk dallohet shumë nga gazetarët. Nuk ka të dhëna për atë se sa gazetarë dhe gazetarë kanë nënshkruar marrëveshje pune, por vlerësohet se punëdhënësit në përgjithësi, kur bëhet fjalë për gazetarët e punësuar në afat të pacaktuar, i respektojnë të drejtat e parapara me ligj siç është pagesa e rrogave, mungesa gjatë lehonisë dhe pushimi i paguar. Pozita e gazetarëve të lirë (freelancer) që janë në numër të vogël në shtetin tonë, ka qenë shumë e rëndë dhe e pasigurt, sidomos gjatë krizës shëndetësore të shkaktuar nga Kovid-19. Një numër i vogël mediesh private kanë organizim sindikalist, respektivisht tek gazetarët ende ekziston frikë apo mosinteresim për organizim sindikalist në medien ku punojnë. Përrjashtim është servisi publik radiodifuziv ku gazetarët janë të organizuar në një sindikatë të veçantë, që nuk është pjesë e SPGPM-së. Marrëveshje kolektive me mediet private nuk ka askund në sektor. Gazetarët

— INDIKATORI 1.5

frikësohen që ti padisin redaktorët, menaxherët apo pronarët e medieve kur iu cenohen të drejtat e tyre të punëtorit. Në vitin 2021, nuk kishte asnjë rast në të cilin ndonjë gazetar paditë person udhëheqës për mobing, ndërsa nuk ka patur as ndonjë vendim të plotfuqishëm për vepër të tillë. Gazetarët në redaksi nuk marrin ndihmë falas juridike në situatë kur i padisin për shpifje, ofendim dhe ngjashëm. Në situata të tilla, SHGM iu ofron gazetarëve ndihmë juridike falas, dhe ju ofron mbrojtje juridike gjatë proceseve para gjykatave të vendit.



## Parandalimi

3,76

Gazetarët dhe aktorët e medias kanë qasje në masa mbrojtëse të menjëhershme dhe efektive kur kërcënohen

3,34

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias (jeta apo integriteti fizik i të cilëve është në rrezik real dhe të menjëhershëm) kanë qasje në mekanizma të mbrojtjes speciale/sigurisë

3,42

Gazetarët kanë qasje në masa ligjore dhe mekanizma mbështetës kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore

3,64

Është krijuar praktika e dënimit të rregullt publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe medieve

3,78

Autoritetet policore janë të ndjeshme ndaj çështjeve të mbrojtjes së gazetarëve

4,61

1.00  
2.00  
3.00  
4.00  
5.00  
6.00  
7.00



Nuk ekzistojnë mekanizma institucionale për mbrojtje direkte të gazetarëve në raste të kërcënimeve dhe sulmeve apo, funksionarë nxisin sulme ndaj gazetarëve, ndërsa policët sillen skajshmërisht ashpër me gazetarët.

Janë vendosur të gjitha mekanizmat institucionale për ndihmë direkte të gazetarëve në rast të sulmeve, funksionarë i dekurajojnë vazhdimisht dhe në mënyrë publike sulmet ndaj gazetarëve, zyrtarët policor i trajtojnë gazetarët me respekt

22

# Gazetarët dhe aktorët e tjerë mediatik kanë qasje direkte deri tek masat mbrojtëse efektive kur janë të ekspozuar ndaj kërcënimeve

**Rezultati për vitin 2020: 3.34 /  
Rezultati për vitin 2021: 3.34**

**Gjatë vitit 2021, nuk kishte ndryshime lidhur me ekzistimin e mekanizmave të shpejtë dhe efektiv për mbrojtje të gazetarëve në raste të kërcënimeve dhe sulmeve. Mekanizmi për denoncim të sulmeve nga ana e gazetarëve në MPB, respektivisht linja për denoncim të shpejtë dhe ndihmë të gazetarëve në raste të sulmeve nuk hyri në funksion as gjatë vitit 2021. Gazetarët ishin cak i sulmeve dhe nuk kishin institucion ku të drejtohen në mënyrë direkte për mbështetje dhe ndihmë, përveç në Sektorin për Kriminalitet Kompjuterik dhe Forenzikë pranë MPB-së dhe deri tek SHGM-ja. Prej pesë rasteve të regjistruara të sulmeve, vetëm një ishte procesuar.**

Që prej vitit 2018, me mbështetje të Misionit të OSBE-së në Shkup, Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik vendosi një linjë telefonike për mbështetje të gazetarëve dhe punonjësve mediatik në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Pas heqjes nga përdorimi të linjës, mbeti mundësia për denoncim të sulmeve online, nëpërmjet një formulari të vendosur nga Sindikata në ueb faqen e saj - <https://ssnm.org.mk/prijavi>. Edhe në këtë rast, mbështetja ishte ofruar nga Misioni i OSBE-së në Shkup. Mekanizmi me linjën telefonike kishte për qëllim mbështetjen dhe këshillimin e gazetarëve dhe punonjësve mediatik në raste të kërcënimeve, shantazheve, sulmeve verbale ose fizike, sulmeve online, dhunës së bazuar në gjini, shkatërrimit të pronës private dhe profesionale dhe sulmeve ndaj redaksive dhe shtëpive të gazetarëve. Linja telefonike falas nuk funksionoi edhe në vitin 2021 ndërsa denoncimet për sulme online të gazetarëve që lidheshin me sulmet dhe kërcënimet online ndaj gazetarëve, dorëzoheshin deri tek Sektori për Kriminalitet Kompjuterik pranë MPB-së në adresën elektronike [cybercrime@moi.gov.mk](mailto:cybercrime@moi.gov.mk). Sipas regjistrimit të SHGM-së, prej gjithsej pesë rasteve



— INDIKATORI 2.1

të regjistruara në vitin 2021, një ishte drejtuar online apo nëpërmjet rrjeteve sociale. Pasi që ishte paraqitur në MBP, Prokuroria Publike nisi procedurën e cila ende po vijon. Për sulmet e tjera, SHGM nuk ka informacion nëse janë iniciuar procedura për zgjidhjen e tyre. Institucionet kompetente nuk bashkëpunojnë sa duhet, nuk zhvillojnë hetime efikase dhe rrallë herë i përndjekin autorët e kërcënimeve apo sulmeve sipas detyrës zyrtare. Posaçërisht shqetëson gjuha e urrejtjes dhe etiketimi i gazetarëve dhe punonjësve mediatik nga ana e politikanëve dhe bartësve të funksioneve publike.

# Gazetarët dhe aktorët e tjerë mediatik (jetët apo integriteti i të cilëve është realisht në rrezik direkt) kanë qasje deri tek mekanizmat speciale për mbrojtje/siguri

**Rezultati për vitin 2020: 3.42 / Rezultati për vitin 2021: 3.42**

**Gjatë vitit 2021 nuk kishte ndryshime sa i përket qasjes deri tek masat e posaçme për mbrojtje fizike të gazetarëve. Në rregullativën ligjore ekzistojnë dispozita të përgjithshme sipas të cilave gazetarët do të mund të kërkonin mbrojtje në rast të ndonjë kërcënimi serioz ndaj jetës së tyre nga ndonjë person i njohur, por nuk është e qartë se kjo procedurë e tillë është e zbatueshme në mënyrë praktike. Ekziston procedurë ligjore por procedura për vlerësimin e rrezikut nuk është e definuar në mënyrë të qartë.**

Ligji për procedurë penale të Maqedonisë së Veriut përmban dispozita me të cilat gjatë procedurës hetimore rregullohet veprimi i organeve gjyqësore, me qëllim që të pamundësohet që "personi i akuzuar ta pengojë vijimin apo zhvillimin e papenguar të procedurës penale dhe mbrojtjen e viktimës".

Nga aspekti formal-juridik, bëhet fjalë për masa të kujdesit që janë konstatuar në nenin 146 nga Ligji për procedurë penale, më konkretisht, paragrafi 1, pika 6, i cili thotë "...6) ndalesë për afrim apo vendosjes, më konkretisht zhvillim të kontakteve apo lidhjeve me persona të caktuar", ndërsa zbatohet vetëm kur autori i veprës penale është i njohur, kur ekziston tashmë një autor i veprës penale, kur ekziston kallëzim penal dhe kur është filluar procedura. Këto masa të kujdesit i propozon prokurori publik, ndërsa i cakton gjykatësi i procedurës paraprake duke vlerësuar seriozitetin e situatës, llojin e veprës penale, rrezikun për viktimën e të tjerë.

Kjo do të thotë se në ligj është vendosur një mekanizëm i përgjithshëm për mbrojtje që gazetarët mund ta shfrytëzojnë në rast të ndonjë kërcënimi më serioz ndaj jetës së tyre, por

— INDIKATORI 2.2

kjo do të ishte e zbatueshme në mënyrë praktike vetëm në rast se personi që bën kërcënimin është i njohur, e jo edhe në situata kur autori i kërcënimit është i panjohur. Raste të tjera kur gazetarët kanë kërkuar mbrojtje fizike nga Ministria e Punëve të Brendshme. SHGM-ja nuk ka regjistruar gjatë vitit 2021.

# Gazetaret kanë qasje në masa ligjore dhe mekanizma për mbështetje kur ballafaqohen me kërcënime, ngacmim dhe dhunë me bazë gjinore

**Rezultati për vitin 2020: 3.64 /  
Rezultati për vitin 2021: 3.64**

**Në vitin 2021, gjendja lidhur me qasjen e gazetareve deri tek ndihma juridike apo masave të tjera të mbështetjes në rast të kërcënimeve, sulmeve apo diskriminimit në bazë të gjinisë, nuk ishte ndryshuar. Ende nuk ishte vendosur mekanizëm për ndihmë juridike falas për të cilëndo viktimë, përfshirë këtu e gazetaret. Të gjithë sulmet gazetaret i denoncojnë në SHGM. Deri tek SHGM-ja në vitin 2021 janë denoncuar tre sulme, por numri i tyre real është shumë më i lartë. Gazetaret shumë rrallë i denoncojnë rastet e diskriminimit të bazuar në gjini tek institucionet kompetente.**

Konventa e Stambollit është ratifikuar në Maqedoninë e Veriut në vitin 2018, ndërsa dispozitat e saj janë inkuadruar në Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje, e përpiluar gjatë vitit 2020, ndërsa e miratuar në janar të vitit 2021.

Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, i përpiluar gjatë vitit 2020, është miratuar në janar të vitit 2021. Duke marrë parasysh se Ligji është sjellë në janar të vitit 2021, sistemi i mbështetjes së tillë në shtet ende nuk ishte vendosur. Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhunës në Familje ndalon çfarëdo lloji të dhunës së bazuar gjinore ndaj grave dhe garanton mekanizma themelore për mbrojtje efektive të viktimave nga çfarëdo forme e dhunës së bazuar gjinore. Poashtu, ky ligj përmban edhe obligime për institucionet për vendosjen masave preventive për parandalimin dhe mbrojtjen nga çdo lloj i dhunës së bazuar gjinore, dhe për ndihmë falas juridike për viktimat nga dhuna e bazuar gjinore. Ende nuk është vendosur mekanizëm i posaçëm në nivel ndërinstytucional që do të ofronte ndihmë juridike për viktimat e dhunës së bazuar gjinore, përfshirë këtu edhe gazetaret . Sipas praktikës

— INDIKATORI 2.3

së SHGM-së, gazetaret që kanë qenë viktime të ngacmimit, sulmeve apo kërcënimeve në bazë gjinore, deri më tani këtë gjë e kanë denoncuar kryesisht në MPB, por edhe në SHGM. Deri në këtë moment SHGM nuk disponon me informacionin se sa denoncime të gazetareve lidhur me dhunë të bazuar në gjini, apo kërcënime janë dorëzuar deri tek MPB-ja gjatë vitit 2021, por tek regjistri që e mban SHGM-ja për sulme, gjatë vitit 2021 janë regjistruar tre denoncime nga gazetaret. Në rast të diskriminimit të gazetarëve në vendin e punës, ata mund të drejtohen edhe deri tek Komisioni për Mbrojtje dhe Parandalim nga Diskriminimi. Megjithatë, sipas njohurive të SHGM-së, gazetaret rrallë herë e shfrytëzojnë këtë mundësi, me gjasë për shkak të frikës se mund të ndjejnë pasoja në vendin e punës.

# Është vendosur praktikë e dënimit të rregullt publik të rasteve të kërcënimit dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave

**Rezultati për vitin 2020: 3.78 / Rezultati për vitin 2021: 3.78**

**Gjendja në vitin 2021 nuk ishte ndryshuar në krahasim me vitin paraprak. Është vendosur një praktikë e dënimit publik të sulmeve ndaj gazetarëve. Bartësit e funksioneve publike kryesisht përmbahen nga sulmet verbale ndaj gazetarëve, me përjashtim të disa rasteve kur politikanë dhe funksionarë publik kanë dërguar sulme verbale në adresë të gazetarëve. SHGM gjatë vitit 2021 ka vërejtur tre raste të tilla.**

Gjatë vitit 2021 ka pasur më shumë shembuj kur funksionarë të zgjedhur apo emëruar, në mënyrë të qartë dhe pa dyshim i kanë dënuar sulmet ndaj gazetarëve. Vlerësim i përgjithshëm është se ekziston praktikë e dënimit në mënyrë publike të sulmeve ndaj gazetarëve por ka edhe shembuj të kundërt që janë vërejtur gjatë vitit 2021. Bëhet fjalë për raste kur deputetë, funksionarë të Qeverisë, apo kryetarë komunash, kanë zhvlerësuar ose nënçmuar publikisht gazetarë në konferenca për medie. Rasti më i theksuar negativ i zhvlerësimit të gazetarit ishte ai i kryetarit të komunës së Karposhit Stevço Jakimovski në nëntor të viti 2021. Gjatë pyetjeve të gazetarëve ndaj kryetarit të Karposhit pas mbarimit të seancës së parë gjyqësore për procedurën në të cilën ai akuzohet për keqpërdorim të detyrës zyrtare, ai i akuzoi gazetarët se prania e tyre është orkestruar nga “një qendër”. Shembull tjetër është sjellja e kryetarit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) gjatë një pres konference lidhur me rezultatet e zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Ai iu drejtua gazetarëve të medieve online me nënçmim, dhe në vend se të përgjigjet në pyetjen e parashtruar nga një gazetarë, ai ka hyrë në zënkë verbale me të. Megjithatë, vlerësimi i përgjithshëm është se atmosfera në të cilën punojnë gazetarët në përgjithësi, duke përfshirë edhe ato që hetojnë korrupsionin, është shumë më e lirë. Bartësit e funksioneve publike kryesisht përmbahen nga sulmet verbale ndaj

— INDIKATORI 2.4

gazetarëve, përveç në raste të caktuara të disa incidenteve. Gjatë vitit 2021, SHGM ka regjistruar vetëm dy raste të tilla, rastin me kryetarin e Karposhit Stevço Jakimovski në nëntorin e vitit 2021, kur gjatë pyetjeve të gazetarëve ndaj tij pas mbarimit të seancës së parë gjyqësore për procedurën në të cilën ai akuzohet për keqpërdorim të detyrës zyrtare, ai i akuzoi gazetarët se prania e tyre është orkestruar nga “një qendër”.

Rasti tjetër ishte sjellja e kryetarit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) gjatë një pres konference lidhur me rezultatet e zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Ai u është drejtuar gazetarëve të medieve online me nënçmim, dhe në vend se të përgjigjet në pyetjen e parashtruar nga një gazetarë, ai ka hyrë në zënkë verbale me të.

# Zyrtarët policor janë të ndjeshëm për çështjen e mbrojtjes së gazetarëve

**Rezultati për vitin 2020: 4.50 / Rezultati për vitin 2021: 4.61**

**Vlerësimi i përgjithshëm është se policia gjatë vitit 2021 ka treguar sjellje korrekte ndaj gazetarëve dhe medieve në raste të ndryshme. Jepet rëndësi që gjatë trajtimeve të zyrtarëve policorë, të përfshihen tema që lidhen me të drejtat e njeriut, ndërsa edhe në kodekset dhe ligjet sipas të cilëve punon policia, janë vendosur të gjithë standardet ndërkombëtare. Bashkëpunimi i rregullt mes SHGM-së dhe MPB-së ka vazhduar edhe gjatë vitit 2021.**

Standardet ndërkombëtare për respektim të të drejtave të njeriut janë inkuadruar në Kodeksin për Etikë në Polici, Ligjin për Polici dhe një sërë ligjesh të tjera relevante. Trajnimi për zyrtarët policorë që zbatohet në kuadër të MPB-së, përmban edhe module që kanë të bëjnë me njoftimin e të drejtave themelore të njeriut që janë konstatuar me konventat dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare. Përpos kësaj, SHGM dhe MPB kanë zhvilluar trajnime të përbashkëta që kanë pasur për qëllim njoftimin e zyrtarëve policorë me rolin e gazetarëve në një shoqëri demokratike.

Gjatë vitit 2021, për shkak të kufizimeve të pandemisë, bashkëpunimi mes SHGM-së dhe MPB-së gjatë organizimit të trajnimeve është realizuar me një intensitet më të vogël. Janë organizuar dy trajnime bashkë me Sektorin për Kontroll të Brendshëm, Hetime Kriminallistike dhe Standarde Profesionale, si dhe me komandantë të stacioneve policore në Shkup.

Në dhjetor të vitit 2017 është nënshkruar Memorandumi për Bashkëpunim, ndërsa në vitin 2019 është vendosur edhe Protokolli për Bashkëpunim mes SHGM-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, qëllimi i të cilëve është kultivimi dhe promovimi i marrëdhënieve të mira mes punonjësve mediatik dhe zyrtarëve policorë.

Në kontekst të këtij bashkëpunimi, SHGM ka publikuar disa doracakë të cilat përveç për gazetarët, janë destinuar edhe për zyrtarët policorë. Gjatë vitit 2021 nuk janë regjistruar probleme më serioze në sjelljen e policëve ndaj gazetarëve dhe medieve.





## Proces



# Njësitë dhe/ose zyrtarët e specializuar hetimorë janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve

**Rezultati për vitin 2020: 3.29 / Rezultati për vitin 2021: 3.29**

**Bashkëpunimi mes institucioneve kompetente edhe në vitin 2021 nuk ishte përmirësuar dhe nuk rezultoi me efikasitetin e mjaftueshëm për të zbuluar autorët e sulmeve. Prokurorët publik janë tejet pasiv kur bëhet fjalë për nisjen e procedurave. Tek prokurorët publik nuk ka persona të përcaktuar për zhvillimin e hetimeve për sulme ndaj gazetarëve. Nuk janë miratuar as udhëzime të posaçme që do të ndihmojnë për zhvillimin më efikas të hetimeve.**

Institucionet kompetente ende nuk kanë formuar reparte të veçanta dhe nuk kanë përcaktuar persona të punësuar për hetimet dhe procedurat që lidhen me aktet e dhunës ndaj gazetarëve. SHGM e ka ngritur këtë çështje gjatë vitit 2020 gjatë takimeve me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe me ato të Prokurorisë Themelore Publike. Iniciativa e SHGM-së që të formohen reparte të tilla dhe të trajnohen kuadro ka hasur në përgjigje pozitive, por në vitin 2021 PTHP nuk ka ndërmarrë hapa në këtë drejtim. Në institucione ende nuk ka as udhëzime të posaçme për zbulim efikas dhe përndjekje të autorëve të sulmeve ndaj gazetarëve. Disa udhëzime në këtë drejtim janë vendosur në dokumentet që SHGM i ka përgatitur në bashkëpunim me MPB-në: "Doracakut për sigurinë e gazetarëve gjatë ngjarjeve me rrezik të lartë", "Udhëzimi për raportim profesional për ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin", dhe "Protokolli për informim për raste që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin".

Institucionet kompetente nuk bashkëpunojnë mjaftueshëm dhe rrallë herë ngrenë akuza ndaj autorëve të kërcënimeve dhe sulmeve, ndërsa në rastet kur janë ngritur hetime, ato

— INDIKATORI 3.1

zhvillohen në mënyrë të ngadalshme dhe joefektive. Prandaj, në komunikim me MPB-në dhe PTHP-në, SHGM vazhdimisht insiston që të përforcohet bashkëpunimi mes tyre dhe të hapen reparte të veçanta. të caktohen persona që do të jenë të trajnuar dhe fokusuar në veprim për raste të sulmeve dhe kërcënimit të sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

# Hetimet e sulmeve të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatik zhvillohen me efikasitet (në mënyrë të pavarur, rrënjësore dhe të shpejtë)

**Rezultati për vitin 2020: 3.28 / Rezultati për vitin 2021: 3.32**

**Edhe pse mosndëshkueshmëria është ende një problem tejet i madh, gjatë vitit 2021 është arritur një përparim i vogël, para së gjithash për shkak të sanksionimit të shpejtë dhe efikas të një kërcënimi tejet serioz të dhënë ndaj gazetarëve online. Mbetet problemi i hetimeve të ngadalshme dhe jo efikase, ndërsa për sulme të caktuara ndaj gazetarëve nuk janë ngritur akuza fare. Por, megjithatë është pozitive që institucionet kompetente janë të hapura për bashkëpunim me SHGM-në dhe gjatë konsultimeve të përbashkëta shfaqin gatishmëri që të punojnë në përmirësimin e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatik.**

Në vitin 2021 kishte vetëm një sulm, respektivisht një kërcënim serioz ndaj gazetarëve dhe medieve online për çka ishte iniciuar procedurë para institucioneve kompetente. Gjatë zgjedhjeve lokale, cak i sulmit dhe kërcënimeve kanë qenë edhe tre gazetarë, të cilat i kanë denoncuar rastet deri tek zyra e SHGM-së. Për rastet e gazetarëve Xhumadije Ibrahim, Salije Sadiku dhe Ferikan Iljazi Arifi lidhur me sulmet gjatë procesit zgjedhor, SHGM ka dorëzuar parashtresa edhe deri tek MPB-ja edhe deri tek KSHZ-ja por ende deri sot e kësaj dite nuk ka epilog.

Për rastin e kërcënimit serioz ndaj gazetarëve dhe medieve online, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë deri tek SPB – Tetovë ka dorëzuar kërkesë për veprim pas denoncimeve për kërcënim të sigurisë së gazetarëve dhe medieve në rrjetin social Fejsbuk. Bëhet fjalë për rast në të cilin nga një profil në këtë rrjet sociale i emëruar si Arben Esati, ishte publikuar përmbytje me kërcënime eksplicite ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik nga mediet si : Pa Censurë, Tv21, Gazeta Ekspress, Tetova Sot, Koha Tv, Koha News, Kumanova Sot, Tv Shenja dhe Lajm

— INDIKATORI 3.2

Press, Por edhe për këtë rast edhe sot e kësaj dite nuk kemi epilog gjyqësor. Mosndëshkueshmëria është ende një problem tejet i madh, para së gjithash për shkak të kapaciteteve dhe bashkëpunimit të pamjaftueshëm me institucionet kompetente. Sa i përket policisë, një pjesë e kërcënimeve procesohen shpejtë, por më tej procedura ngecë apo është shumë e ngadalshme kur duhet të ngrihen akuza. Është ndodhi tejet e rrallë që hetimi të përfundojë me vendim gjyqësor në të cilin dënohet autorët e sulmeve apo kërcënimeve. Autorët e sulmeve ndaj gazetarëve zakonisht nuk përndiqen sipas detyrës zyrtare, gjë që i detyron gazetarët të iniciojnë padi private. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se në dhjetor të vitit 2021, ishte sjellë vendim gjyqësor në favor të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, me të cilën ishte shqiptuar sanksion ndaj personit i cili kishte bërë kërcënim serioz online ndaj të gjithë gazetarëve nëpërmjet faqes së Fejsbukut të SHGM-së. Ky është shembulli i parë kur Prokuroria dhe gjykata në mënyrë të plotë hetojnë dhe sanksionojnë një vepër serioze ndaj gazetarëve, të kryer nëpërmjet platformës online.

# Gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias mbrohen me efikasitet nga forma të ndryshme të ngacmimit në internet

**Rezultati për vitin 2020: 3.46 /  
Rezultati për vitin 2021: 3.46**

**Gjatë vitit 2021, ka patur një përmirësim të konsiderueshëm për mbrojtje të gazetarëve nga sulmet online, kjo pasi që institucionet reagon me shpejtësi dhe efikasitet që të gjendet dhe sanksionohet autori i kërcënimit serioz ndaj të gjithë gazetarëve, i shkruar në faqen e Fejsbukut të SHGM-së. Megjithatë, SHGM ende nuk ka marrë informacion se si prokuroria ka vepruar lidhur me sulmet e tjera online ndaj gazetarëve të kryera gjatë vitit 2021.**

Sipas Kodit Penal të RMV-së, sulmet online ndaj gazetarëve mund të ndëshkohen sipas dy bazave. Së pari, sipas nenit 394-g, shpërndarja e përmbajtjeve me "gjuhë të urrejtjes" në publik, nëpërmjet sistemit kompjuterik, ndaj një personi apo grupit të personave në baza të ndryshme, përfshirë edhe bazën e "statusit personal dhe shoqëror", dënohet me një deri në pesë vite burg. Në këtë nen nuk është përdorur në mënyrë eksplicite termi "gjuhë e urrejtjes" por një shpjegim më i gjerë i përmbajtjeve në të cilat përfshihen : materiale raciste dhe ksenofobike me shkrim, fotografi apo formë tjetër e reprezentimit të idesë apo teorisë që ndihmon, promovon apo nxitë urrejtje , diskriminim ose dhunë. Së dyti, sipas nenit 144, paragrafi 1, secili kërcënim serioz për sulm ndaj jetës apo trupit së dikujt ose jetës apo trupit të personit të afërt të tij, do të dënohet me para ose me burg deri në gjashtë muaj. Përpos kësaj, sipas paragrafit 4 të të njëjtit nen, secili që do të drejtojë kërcënim nëpërmjet sistemit informatik, se do të kryejë veprë penale (për të cilën është paraparë dënim me burg prej pesë vitesh apo dënim më i rëndë) ndaj cilit do person apo grupi, në çfarëdo baze, përfshirë edhe bazën e "statusit personal dhe shoqëror", do të dënohet me burg prej një deri në pesë vite. Sipas praktikës së deritanishme, PTHP ka vepruar sipas detyrës zyrtare në bazë të paragrafit 4 nga neni 144 i Kodit Penal, vetëm në rast se ka ekzistuar një kërcënim eksplicit për veprë penale për të cilën është paraparë dënim me burg mbi pesë vitesh.

Pikërisht për shkak të këtyre arsyeve, janë propozuar ndryshime në Kodin Penal që ti zgjidhen duart prokuroria për të vepruar dhe përndjekur çdo formë të kërcënimeve (online dhe offline) ndaj gazetarëve. Deri në fund të vitit 2021, këto ndryshime në Kodin Penal nuk ishin miratuar ende në Parlament.

Rrallë herë ka ndodhur që ndonjë gazetarë të ngrejë padi private për kërcënim online apo për ngacmim, dhe për këtë shkak, këto raste mbetnin pa u zgjidhur dhe kontribuonin në krijimin e një klime të mosndëshkueshmërisë. Sipas statistikës së SHGM-së, gjatë vitit 2021 ka pasur gjithsej pesë kërcënime, prej të cilave njëra është dërguar nëpërmjet platformave online dhe ka qenë kërcënim për jetën e gazetarëve. Kërcënimi është denoncuar deri tek Sektori për kriminalitet kompjuterik dhe forenzikë digjitale pranë MPB-së. Më 29 dhjetor të vitit 2021, ishte sjellë vendim gjyqësor në favor të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) për rastin në të cilin nga profili me emrin "Sasho Mitev" është shkruar koment në një postim në faqen e Fejsbukut të SHGM-së. Sipas vendimit të Gjykatës Themelore Penale, Sasho Mitev është fajtor sipas nenit 394-g nga Kodi Penal, dhe i shqiptohet dënim me burg prej tre muajsh për shkak se ka "shpërndarë materiale të shkruara me përmbajtje raciste dhe ksenofobie që nxisin dhe promovojnë urrejtje dhe dhunë....ndaj një grupi gazetarësh, në bazë të statusit personal dhe shoqëror.". Ky është shembulli i parë kur gjykata dhe prokuroria e kanë mbaruar plotësisht procedurën për kërcënim online ndaj gazetarëve.

# Hetimet e të gjitha llojeve të sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias, bëhen me transparencë

**Rezultati për vitin 2020: 3.09 /  
Rezultati për vitin 2021: 3.09**

**Sa i përket transparencës së procedurave gjyqësore në të cilat palë janë gazetarët, gjendja nuk është përmirësuar. Gjykata Themelore Civile dhe Gjykata Themelore Penale në Shkup nuk ofrojnë informacione të detajuara lidhur me procedurat gjyqësore për sulme ndaj gazetarëve që kanë ndodhur gjatë viteve të fundit. Gjykatat nuk kanë praktikë që ta informojnë opinionin për procedurat kundër gazetarëve apo në të cilat gazetarët janë palë pasi që kanë qenë pre e sulmit. Përpos kësaj, sistemi informatik i automatizuar për menaxhim me raste (AKMIS) nuk jep mundësi për kërkim preciz për procedurat e kaluara apo ato rrjedhëse ku gazetarët janë palë, dhe kështu opinionin ka vështirësi që të sigurojë qasje deri tek këto informacione.**

Perceptimi i përgjithshëm është se gjykatat nuk janë mjaftueshëm transparente lidhur me rrjedhën e proceseve gjyqësore për sulme ndaj gazetarëve. Gjykatat Themelore Civile dhe Penale nuk ofrojnë detaje për procedurat gjyqësore të sulmeve ndaj gazetarëve që kanë ndodhur gjatë viteve të fundit. Gjykatat nuk kanë praktikë që ta informojnë opinionin për procedura që zhvillohen kundër gazetarëve apo ku ata janë palë për shkak të sulmeve apo kërcënimeve ndaj tyre. Sistemi informatik i automatizuar për menaxhim me raste (AKMIS) nuk jep mundësi për kërkim preciz për procedurat e kaluara apo ato rrjedhëse ku gazetarët janë palë, dhe kështu opinionin ka vështirësi që të sigurojë qasje deri tek këto informacione. Gjatë vitit 2021, SHGM arriti që të marr nga Gjykata Civile vetëm informacionin se ekzistojnë gjithsej dhjetë lëndë aktive për veprat e shpifjes dhe ofendimit, në të cilat si palë paraqitet ndonjë gazetar apo medie.



# Organet shtetërore kanë vendosur sisteme për mbledhje të të dhënave kualitative statistikore, në mënyrë që të pengohet mosndëshkueshmëria

**Rezultati për vitin 2020: 3.41 / Rezultati për vitin 2021: 3.41**


**Gjendja në krahasim me vitin paraprak nuk është ndryshuar. Gjykatat dhe institucionet kompetente edhe përkundër iniciativave të SHGM-së, ende nuk kanë vendosur sisteme kualitative statistike në bazë të të cilave mund të nxirren të dhëna precize për të gjitha procedurat gjyqësore ku janë palë mediet apo gazetarët. Bazat e të dhënave të gjykatave nuk lejojnë kërkim të të dhënave sipas kriterëve të ndryshme.**

Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka vendosur një regjistër të të dhënave statistikore për sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve. Ministria e brendshme deri më tani, vetëm në vitin 2018 ka dalë me një njoftim në të cilin ka publikuar të dhëna statistikore për numrin e sulmeve ndaj gazetarëve dhe medieve. As Gjykata Penale as ajo Civile në Shkup, nuk kanë mundësi që të japin informacione të detajuara lidhur me lëndët në të cilat gazetarët paraqiten si palë. Arsyeimi i tyre është se sistemi i ri për menaxhimin e lëndëve (AKMIS) bazohet në kode e jo në emra dhe profesione të palëve.

# IV

## Siguria fizike

4,17



41

# Kërcënimet dhe ngacmimet që nuk kanë lidhje me sigurinë fizike

**Rezultati për vitin 2020: 3.91 / Rezultati për vitin 2021: 3.97**

**Në vitin 2021 kishte një përmirësim të vogël në kontekst të këtij lloji të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik, për dallim prej vitit 2020 kur SHGM ka regjistruar shtatë sulme. Janë regjistruar një numër i vogël i kërcënimeve, ndërsa ato nuk janë të fokusuara ndaj kërcënimit të sigurisë fizike të gazetarëve. Megjithatë, shqetësues është fakti se në mesin e autorëve janë edhe zyrtarë policorë dhe përfaqësues të partive politike.**

Në vitin 2021, kishte një përmirësim të vogël në kontekst të këtij lloji të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në shtet, për dallim prej vitit 2020 kur SHGM-ja regjistroi shtatë raste. Tre rastet e sulmeve verbale ndaj gazetarëve gjatë kohës së zgjedhjeve lokale në vitin 2021:

- Xhumadije Ibrahim nga TV Klan Maqedoni, u ballafaqua me sulm verbal nga kandidati i Alencës për Shqipëtarët për kryetar të Tetovës, Vullnet Murseli.
- Ferikan Iljazi Arifi nga Euronews Albania ishte sulmuar verbalisht nga anëtar i Këshillit Zgjedhor dhe nga një zyrtar policor, gjatë raportimit për zgjedhjet lokale të vitit të kalur, dhe
- Salije Sadiku nga TV21 – sulm verbal nga ana e kandidatit të pavarur për kryetar të Kërçovës, Fatmir Limani.

# Kërcënime kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve

**Rezultati për vitin 2020: 3.89 /  
Rezultati për vitin 2021: 3.93**

**Në vitin 2021 është regjistruar vetëm një kërcënim që ka të bëjë me kërcënimin e sigurisë fizike apo jetën e gazetarëve, që paraqet një përmirësim në krahasim me vitin 2020, kur SHGM kishte regjistruar tre raste. MPB ka dorëzuar njoftim në adresë të SHGM-së se është ngritur kallëzim penale kundër A.E (36) nga fshati Tearcë i Tetovës, për shkak të ekzistimit të bazës së dyshimit për kryerjen e veprës penale “kërcënim i sigurisë” kundër gazetarëve. Përgjigja e MPB-së lidhur me këtë rast është për tu përshëndetur, ndërsa hapi i ardhshëm është përgjigja proaktive e prokurorisë, pastaj gjykatës, me qëllim që ata që i cenojnë të drejtat e gazetarëve, të ballafaqohen me drejtësinë. Për këtë rast MPB ka nisur procedurë kundër kërcënuesit, por ende nuk ka informacion deri në cilën fazë është procedura lidhur me këtë rast. Fakti që ky lloj i kërcënimeve bëhen kryesisht online dhe më së shpejti cak i sulmit janë gazetaret, është tejet shqetësues.**

Nëse bëhet krahasim, në vitin 2020 SHGM kishte regjistruar tre sulme të tilla, ndërsa gjatë vitit të kaluar është regjistruar vetëm një shembull i tillë.

Në mars të vitit 2021, SHGM regjistroi një sulm të tillë ndaj medieve dhe kërcënimit ndaj një grupi të gazetarëve nga mediet Pa Censurë, Tv21, Gazeta Ekspress, Tetova Sot, Koha Tv, Koha News, Kumanova Sot, Tv Shenja dhe Lajm Press nëpërmjet profilit të personit Arben Esati, duke publikuar përmbajtje me kërcënime eksplicite ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatic nga mediet e lartpërmendura.

# Sulmet fizike

**Rezultatet për vitin 2020: 4.18 /  
Rezultatet për vitin 2021: 4.25**

**Në vitin 2021 është regjistruar një sulm fizik ndaj gazetarëve, për dallim prej vitit 2020 kur kishte dy raste të tilla. Më konkretisht gjatë kohës së protestave të qytetarëve të pakënaqur dhe familjarëve të të akuzuarve në rastin “Monstra”, në adresë të SHGM-së erdhi denoncim nga kolegë të Agjencisë Mediatike Informative (MIA) se ka pasur tentim për tua marrë pajisjet anëtarëve të ekipit të tyre, pas çka kameramani është shtyrë ndërsa pajisjet janë dëmtuar. SHGM nëpërmjet një njoftimi me shkrim i dënoi në mënyrë publike sulmuesit.**

Në krahasim me vitin 2020, kur SHGM ka regjistruar dy sulme të llojit të tillë, në vitin 2021 është vërejtur vetëm një sulm i llojit të tillë : SHGM e ka regjistruar sulmin ndaj ekipit të MIA-s gjatë raportimit nga protestat kur disa persona kanë tentuar që t’ia marrin pajisjet ekipit. Gjatë protestave të një grupi qytetarësh për rastin “Monstra”, më 26.2.2021, ka pasur shtyrje dhe tentim për tua marrë pajisjet anëtarëve të ekipit pas çka kameramani është shtyrë ndërsa pajisjet janë dëmtar.

# Kërcënime dhe sulme ndaj medieve dhe shoqatave të gazetarëve

**Rezultati për vitin 2020: 4.53 /  
Rezultati për vitin 2021: 4.53**

**Nuk ka ndryshime në gjendjen krahasuar me vitin paraprak. SHGM gjatë vitit 2021 nuk ka regjistruar asnjë sulm të këtij llojit. Por, duke marrë parasysh se sulmet e viteve të kaluara nuk janë zgjidhur ende, vlerësimi për këtë vit mbetet i njëjtë.**

Në vitin 2020, SHGM ka regjistruar dy raste të kërcënimit ndaj medieve. Në të dy rastet bëhet fjalë për kërcënime të drejtuara ndaj medieve për shkak të punës së tyre hulumtuese në raste të korrupsionit apo kritikave të dhëna në opinion. Pas publikimit të një storjeje hulumtuese lidhur me aktivitetet ndërtimore në lagjen Taftalixhe në Shkup, redaksia e IRL-së ka qenë e eksponuar në presion verbal dhe shqetësim; Ndaj gazetarëve dhe aktivistëve të Civil Media Xhabir Deralla dhe Petrit Saraçini janë drejtuar kërcënime dhe nënçmime nëpërmjet rrjetit social Fejsbuk nga Marjan Kamillovski. Në vitin 2021, SHGM nuk ka regjistruar asnjë sulm të këtij llojit, por, duke marrë parasysh se sulmet e viteve të kaluara nuk janë zgjidhur ende, vlerësimi për këtë vit mbetet i njëjtë.

**Titulli**  
Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor  
Republika e Maqedonisë së Veriut – Raport narrativ i vitit 2021

**Botues**  
Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë



**Autor**  
Millan Spirovski

**Ekspert juridik**  
Ivan Breshkovski

**Ekspert mediatik**  
Marina Tuneva

**Lektor**  
Maja Katarova-Apostollova

**Dizajn**  
comma.rs

Ky publikim është përgatitur me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian dhe Civil Rights Defenders. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i reflekton qëndrimet e Bashkimit Evropian dhe Civil Rights Defenders.

